



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR. 16, DATË 29 : 03 .2024

PËR

“MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË GJIROKASTËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE
PËR FAMILJEN E Z. VULLNET MUHO, I CILI ËSHTË DËMTUAR NGA DJEGIA E
BANESËS SË TIJ PRIVATE, SI REZULTAT I RËNIES SË ZJARRIT”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjin Nr.9936 , datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr.09 , datë 23.03.2018. “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, V.KM Nr.329 , datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprime njerëzore”, V.K.B Nr. datë 14/12/2023 “Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”, Këshilli I Bashkisë në mbledhjen e datës 29 : 03 : 2024

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Gjirokastrë për mbështetje financiare për shtetasin Vullnet Muho, për dëmtimet e banesës së tij si pasojë e rënies së zjarrit
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Gjirokastrë
3. T’i akordojë familjës së shtetasit Z. Vullnet Muho, ndihmë financiare në vlerën prej 200.000 (dyqind mijë) lekë, nga fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2024
Prog.AD115, Kap.01, Art 606.Kod produkti V091AAC
4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Z. Vullnet Muho , përcaktohet sipas kriterëve të V.K.M-së 329, datë 16.05.2012.

5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit z. Vullnet Muho, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit të tij., sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo



KRYETARI I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

